



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA

AGJENSIONI KOSOVAR KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA BORBU PROTIV KORRUPCIJE NA KOSOVU
KOSOVO ANTI-CORRUPTION AGENCY



RAPORTI VJETOR I AGJENSIONIT KOSOVAR KUNDËR KORRUPSIONIT

1 JANAR – 31 DHJETOR
2007

Tabela e përmbajtjes

I.	HYRJE	4
II.	HISTORIKU.....	5
III.	KËSHILLI I AGJENSIONIT KOSOVAR KUNDËR KORRUPSIONIT	6
IV.	ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE STAFI I AGJENSIONIT	6
V.	AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT PËR STRATEGJINË ANTI-KORRUPSION DHE HETIMET ADMINISTRATIVE.....	7
i.	Hetimet Administrative	8
iii.	Edukimi dhe ngritja e vetëdijes së publikut.....	13
VI.	AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT TË PARANDALIMIT TË KORRUPSIONIT	14
i.	Mbikëqyrja e Pasurive.....	14
ii.	Kontrolli i Formularëve të Deklarimit të Pasurive	16
iii.	Konflikti i Interesit.....	17
iv.	Pranimi i Dhuratave	18
VII.	AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT TË SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE	18
i.	Buxheti për vitin 2007	19
ii.	Zyra e Prokurimeve	20
iii.	Burimet Njerëzore.....	21
VIII.	ZYRA PËR MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN	22
i.	Takime me gazetarë dhe qytetarë	22
ii.	Faqja e re zyrtare e internetit	22
iii.	Deklaratat dhe konferencat për shtyp.....	23
iv.	Monitorimi i mediave ne periudhën janar - dhjetor '07	23
v.	Aktivitete dhe bashkëpunimi	23
VIII.	PROBLEMET E NDESHURA	24
IX.	SFIDAT E SË ARDHMES/PLANET	26
X.	KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....	27

SHTOJCA 1: ORGANIGRAMA.....	28
XI. SHTOJCA 2: LISTA E TRAJNIMEVE.....	29
XII. SHTOJCA 3: LISTA SHKRIMEVE MEDIATIKE GJATË VITIT 2007.....	31

I. HYRJE

Gjatë viteve të fundit në Kosovë është bërë gjithmone e më akut problemi i fenomeneve korruptive të cilat kanë minuar stabilitetin ekonomik, shtetin e së drejtës si dhe kanë lëkundur rrënjësisht besimin e publikut tek institucionet e reja të krijuara pas luftës.

Krahas disa përpjekjeve të bëra nga Qeveria e Kosovës që startojnë në vitin 2004 për të marrë masa në bërjen e politikave në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit si dhe ngritjen e mekanizmave përkatës, viti 2007 shënon ngritjen dhe bërjen funksionale të mekanizmit kryesor në luftën kundër korrupsionit në Kosovë, Agjensionit Kosovar kundër Korrupsionit (këtej e tutje në raport – AKK), institucion i cili u themelua si nevojë për të pasur reforma konkrete me prioritet të përcaktuara, zbatimin e strategjive dhe politikave të mirefillta për parandalimin dhe çrrënjosjen e korrupsionit, promovimin e transparencës dhe integritetit të institucioneve qëndrore si dhe përfshirjen e publikut në përpjekjet anti-korrupsion.

AKK-ja është një institucion i ri në këtë fushë dhe në fillimet e tij në ndërmarrjen e veprimeve konkrete kundër veprimeve të dyshuara korruptive, ndërgjegjësimin për një shoqëri të pa korruptuar tek nëpunësit civil, zyrtarët e lartë, sektori publik, media dhe shoqëria civile si dhe publiku në përgjithësi. Gjithashtu, është në hapat e parë për vendosjen e bashkëpunimit të ndërsjellët midis institucioneve, mekanizmave dhe partnerëve për të siguruar fillimin dhe kryerjen e reformave të suksesshme anti-korrupsion.

Ky është raporti i parë vjetor që Agjensioni i paraqet Kuvendit të Kosovës. Raporti vjetor i punës së AKK-së pasqyron aktivitetet dhe iniciativat e ndërmarra gjatë vitit të parë të funksionalitetit të institucionit duke reflektuar në mënyrë të detajuar detyrat e kryera të cilat kanë qenë të përqëndruara në tre shtylla kryesore:

- Zbatimi i ligjit;
- Parandalimi dhe eliminimi e shkaqeve të korrupsionit; dhe
- Edukimi, ngritja e vetëdijes qytetare.

Gjithashtu, raporti paraqet një prezantim gjithëpërfshirës dhe aktual mbi kuadrin ligjor anti-korrupsion, iniciativat e ndërmarra në këtë fushë, mekanizmat institucional të përfshirë në procesin e përmirësimit dhe kompletimit të këtij kuadri, për ta sjellë legjislacionin kosovar në të njëjtin standard me atë ndërkombëtar dhe evropian. Raporti i lejon lexuesit të monitoroj progresin e bërë gjatë periudhës së raportimit si dhe të njohë problemet e hasura gjatë zbatimit të detyrave dhe aktiviteteve të kryera nga Agjensioni Kosovar kundër Korrupsionit.

Në këtë raport do të gjeni përshkrimin dhe vlerësimin për korrupsionin në Kosovë, si dhe masat e ndërmarra në parandalimin apo eliminimin e shkaqeve të korrupsionit dhe ngritjen e vetëdijes qytetare mbi këtë fenomen të dëmshëm për shoqërinë kosovare.

Së fundmi, raporti identifikon prioritetet dhe reformat të cilat Agjensioni do të ndërmarrë në harkun kohor të vitit 2008, duke i dhënë rëndësi arritjes së standardeve në luftimin dhe parandalimin e fenomenit të korrupsionit.

II. HISTORIKU

Agjensioni Kosovar kundër Korrupsionit është i vetmi institucion i pavarur, i konceptuar si mekanizmi themelor në parandalimin dhe luftimin e fenomenit të korrupsionit dhe koordinimin e politikave anti-korrupsion në Kosovë. Agjensioni ushtron përgjegjësitë e përcaktuara në Ligjin kundër Korrupsionit (2004/34), është themeluar në korrik 2006 dhe ka filluar funksionalitetin e tij në 12 shkurt 2007.

Qëllimi dhe puna e Agjensionit është e përqendruar në zbulimin dhe hetimin e rasteve korruptive, përpjekjeve për parandalimin dhe luftimin e fenomenit të korrupsionit, për të ndihmuar në ndërtimin e një shoqërie të shëndoshë e të përparuar kosovare dhe që bazohet në shtetin e së drejtës.

Ligji aktual kundër korrupsionit, që përbën bazën ligjore të funksionimit të Agjensionit, parasheh masat kundër korrupsionit brenda fushës së veprimit të strategjisë dhe planit të veprimit kundër korrupsionit, veçanërisht në fushën e hetimeve administrative të korrupsionit publik, analizimin dhe eliminimin e shkaqeve të korrupsionit, pajtueshmërinë mes mbajtjes së posteve publike dhe kryerjes së aktiviteteve fitimprurëse për personat zyrtar, kufizimet në lidhje me pranimin e dhuratave të lidhura me kryerjen e punëve në detyrë, mbikëqyrjen e pasurive të tyre si dhe të personave në lidhje të afërt me ta dhe kufizimet në lidhje me subjektet kontraktuese që marrin pjesë në tenderët publik.

Fondet për funksionimin e AKK-së sigurohen nga Buxheti i Kosovës dhe deri tani në harkun kohor prej një viti e gjysmë nga momenti kur krijimi i Agjensionit u zyrtarizua, AKK-ja ka hasur në vështirësi të ndryshme për sa i përket alokimit të fondeve të kërkuara për funksionimin normal dhe për të ruajtur pavarësinë e institucionit si dhe mungesës së vazhdueshme të përkrahjes institucionale.

Gjithashtu, AKK-ja ende vuan nga mangësia e plotësisht me numrin e mjaftueshëm të stafit, aktualisht në Agjensionin Kosovar kundër Korrupsionit janë të punësuar vetëm 15 zyrtarë, prej 35 zyrtarëve të miratuar nga Kuvendi i Kosovës (shiko strukturën përkatëse në Shtojcën 1).

Gjithsesi, duhet përmendur fakti se gjatë vitit 2007, Agjensioni Kosovar kundër Korrupsionit i është dhënë asistencë teknike profesionale përmes projekteve CBF (projekt i financuar nga Zyra e UNDP-së në Kosovë dhe Fondacioni Soros në Kosovë) dhe CBEI (projekt i financuar nga EAR dhe menaxhuar nga Zyra e UNDP-së në Kosovë) të cilët kanë bërë të mundur alokimin e 4 këshilltarëve¹ (2 këshilltarë të CBF-it më kohë të plotë dhe 2 këshilltarë të CBEI-t më kohë të pjesshme) pranë Agjensionit në mënyrë që të ofrohet dhe jepet asistencë në hartimin e politikave kombëtare anti-korrupsion, strategjive dhe planeve të veprimit, ngritjen dhe ndërgjegjesimin e publikut mbi punën e këtij institucioni të ri dhe inkurajimin për të raportuar rastet korruptive, plotësimin e kornizës ligjore anti-korrupsion, etj. Asistenca teknike dhe këshilldhënia e këshilltarëve është e pranishme në çdo aktivitet apo iniciativë të ndërmarrë nga Agjensioni.

Asistenca në fjalë pritet të vazhdohet dhe në gjashtë muajt e parë të vitit 2008.

Megjithatë, fundi i vitit 2007 shënoi dhe arritjen e parë për sa i përket alokimit të fondeve të kërkuara për vitin 2008 si dhe vendimin e Qeverisë së Kosovës për miratimin e hapjes së 20 vendeve të mbetura për të plotësuar burimet njerëzore të AKK-së.

¹ Një këshilltar lokal, një këshilltar rajonale dhe dy këshilltarë ndërkombëtar.

Strategjia e AKK-së

Strategjia e punës së AKK-së mbështetet në tre shtylla kryesore të cilat ndihmojnë në realizimin e detyrave dhe përgjegjësive që rrjedhin nga Ligji kundër Korrupsionit si dhe në arritjen e:

- Zbatimit të ligjit ku përfshihen përcjellja e informatave për korrupsion në Prokurorinë Publike të Kosovës si dhe hartimi i ligjeve të reja për plotësimin e kornizës ligjore në këtë fushë, përgatitja dhe zbatimi i strategjisë dhe planit kombëtar të veprimit anti-korrupsion;
- Parandalimit ose eliminimit të shkaqeve të korrupsionit përmes kryerjes së deklaramit të pasurisë së zyrtarëve të lartë, parandalimit të konfliktit të interesit dhe regjistrimit të dhuratave të pranuar nga personat zyrtar; dhe
- Edukimit të zyrtarëve të administratës publike dhe qytetarëve mbi kornizën ligjore dhe mekanizmat aktuale anti-korrupsion, informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut si dhe ngritjen profesionale të stafit.

III. KËSHILLI I AGJENSIONIT KOSOVAR KUNDËR KORRUPSIONIT

Puna e Agjensionit Kosovar kundër Korrupsionit mbikëqyret nga Këshilli i Agjensionit i cili është një organ kolegjal me nëntë përfaqësues nga Kuvendi i Kosovës, Zyra e Kryeministrit, Zyra e Presidentit, Gjykata Supreme, Prokuroria Publike e Kosovës, Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe shoqëria civile. Anëtarët e Këshillit kanë një mandat prej dy vitesh në detyrë. Këshilli aktual ka filluar punën me 1 mars të vitit 2006 dhe mandati i Këshillit aktual mbaron në fund të shkurtit të vitit 2008.

Këshilli zgjidhet nga Kuvendi i Kosovës dhe ka përgjegjësi të kontrollojë në mënyrë të rregullt dhe të plotë punën e Agjensionit dhe mbikëqyrë pasuritë e personave zyrtarë që punojnë në AKK. Agjensioni bazuar në kuadrin ligjor në mënyrë të detyrueshme raporton tek Këshilli i Agjensionit çdo gjashtë muaj në lidhje me përmbajtjen dhe shtrirjen e mbikëqyrjes së pasurive si dhe për gjetjet e Agjensionit në lidhje me papajtueshmërinë, konfliktin e interesave, dhuratat dhe hetimet e përfunduara si dhe punën dhe aktivitetet e detajuara të kryera nga Agjensioni gjatë periudhës së raportuar.

Agjensioni shërben dhe si sekretariat i Këshillit.

Deri më tani, Agjensioni ka paraqitur në Këshill dy raporte të punës gjashtë mujore, përkatësisht për periudhën Korrik – Dhjetor 2006 dhe Janar- Korrik 2007. Raporti vjetor i punës së AKK-së për vitin 2007 do të paraqitet dhe dorëzohet Këshillit, ndërsa pas miratimit nga ana e Këshillit ai kalon në Kuvendin e Kosovës.

IV. ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE STAFI I AGJENSIONIT

Agjensioni Kosovar kundër Korrupsionit e organizon punën e tij në bazë të Rregullave të Brendshme të Funkcionimit të Agjensionit. Këto rregulla pasqyrojnë në mënyrë të detajuar përgjegjësitë e çdo zyrtari në secilin divizion dhe departament.

Agjensioni është i përbërë nga tre departamente, secili departament nga dy nëndivizione dhe katër zyra të veçanta (shiko shtojcën 1). Aktualisht në mënyrë të detajuar në Agjension punojnë:

- në Departamentin për Strategjinë Anti-korrupsion dhe Hetimet Administrative, 4 zyrtarë nga 12 që duhet të ketë gjithsej;
- në Departamentin e Parandalimit të Korrupsionit, 3 zyrtar nga 9 gjithsej;
- në Departamentin e Shërbimeve Administrative, 4 zyrtar nga 9 gjithsej; si dhe
- një asistente ekzekutive, një zyrtar për marrëdhënie me publikun dhe një zyrtar për prokurimet.

Agjensioni ende nuk ka zyrtarin për arkiv.

Kapitujt në vijim paraqesin një tablo të plotë të aktiviteteve të kryera nga secili departament dhe zyre e Agjensionit gjatë periudhës një vjeçare të raportimit, 1 Janar - 31 Dhjetor 2007.

V. AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT PËR STRATEGJINË ANTI-KORRUPSION DHE HETIMET ADMINISTRATIVE

Departamenti për Strategjinë Anti - korrupsion dhe Hetimet Administrative (këtu e tutje Departamenti i Hetimeve) gjatë periudhës një vjeçare ka zhvilluar një aktivitet të ngjeshur në drejtim të zbatimit të mandatit ligjor të përcaktuar me Ligjin kundër Korrupsionit, Rregullat Procedurale të Agjensionit Kosovar kundër Korrupsionit, Vendimin për Organizimin dhe Sistematizimin e Brendshëm të AKK-së si dhe të akteve të tjera të brendshme.

Mandati ligjor i Departamentit të Hetimeve konsiston në zhvillimin e aktiviteteve të mëposhtme:

- a. zhvillimin e hetimeve lidhur me akuzat e supozuara për korrupsion në ato raste kur nuk iniciohet procedurë penale,
- b. përcjelljen e rasteve të hetuara tek Prokuroria Publike e Kosovës për procedim penal të mëtejshëm,
- c. bashkëpunimin me të gjitha autoritetet vendore dhe ndërkombëtare të ngarkuara për zbatimin e ligjit gjatë procedurave hetimore që kryhen nga këto autoritete,
- d. përgatitjen e propozimeve për plotësimin e kuadrit ligjor në fushën e luftimit dhe parandalimit të korrupsionit,
- e. ngritjen e vetëdijes dhe sensibilizimin e opinionit në lidhje me fenomenet korruptive dhe pasojat dhe dëmet që shkaktohen nga korrupsioni,
- f. mbikëqyrjen dhe analizën e të dhënave statistikore që kanë lidhje me gjendjen e korrupsionit në Kosovë.

Në zbatim të mandatit ligjor të sipërpërmendur, aktiviteti njëvjeçar i Departamentit të Hetimeve ka qenë i fokusuar në dy drejtime:

1. Fuqizimi i ligjit, përkatësisht:
 - a. Zhvillimi e hetimeve për të gjitha rastet e dyshuara për korrupsion;
 - b. Plotësimi i legjisllacionit në fushën e anti-korrupsionit.
2. Edukimi dhe ngritja e vetëdijes së publikut për fenomenin e korrupsionit dhe pasojat negative të tij.

i. Hetimet Administrative

Kjo pjesë paraqet një pasqyrë të punës së kryer deri tani në lidhje me rastet e paraqitura në Agjensionin Kosovar kundër Korrupsionit në lidhje me rastet e dyshuara për veprime korruptive, procesin e hetimeve të tyre si dhe procedimin e tyre te prokuroritë publike, dhe organet kompetente policore.

Rastet e paraqitura në periudhën Janar – Dhjetor 2007

Krahasuar me vitin 2006, kur AKK-ja ishte në fillimet e punës së saj dhe pranë departamentit ishin raportuar një numër simbolik i informacioneve në lidhje me veprimet korruptive, vetëm gjatë shtatorit 2007 në linjën telefonike pa pagesë dhe konfidenciale, **044 082 82**, të instaluar me qëllim që qytetarët të raportojnë rastet të korrupsionit, Departamenti i Hetimeve ka marrë rreth **160** thirrje telefonike, si dhe ka pranuar **31** raste të paraqitura nga ana e qytetarëve të cilët kanë bërë kërkesën për fillimin e procedurës së hetimeve duke ofruar dëshmitë e nevojshme për hetimin e këtyre rasteve.

Në krahasim me rastet e paraqitura gjatë vitit 2006, në vitin 2007 rastet kanë veçoritë karakteristike të mëposhtme:

- a. numri shumëfish më i madh i raportimeve të rasteve të dyshuara për korrupsion;
- b. dëmet e supozuara se janë shkaktuar nga veprimet korruptive llogaritet të jenë shumë më të mëdha; dhe
- c. dyshimi i implikimit në këto raste të personave të dyshuar për vepra serioze të korrupsionit nga nivele të larta të pushtetit.

Gjendja e korrupsionit sipas institucioneve

Nga gjendja e korrupsionit në Kosovë dhe shtrirja e tij në institucionet e Kosovës, në bazë të rasteve të paraqitura nga palët dhe ato të hetuara ex - officio nga Agjensionin Kosovar kundër Korrupsionit, kemi situatën si në vijim:

- Sa i përket rasteve të paraqitura për vitin 2007, periudha kohore **janar – dhjetor 2007**, janë paraqitur **gjithsej 124 raste** të dyshuara për veprime korruptive në institucionet publike të Kosovës;
- Ndaj zyrtarëve publik të **Qeverisë së Kosovës** janë paraqitur **36 raste** të dyshuara për veprime korruptive, shprehur në përqindje kjo shifër përbën 29.03 % të rasteve;
- Ndaj zyrtarëve publik në **gjykata** janë paraqitur **35 raste** apo shprehur në përqindje 28.22 % e rasteve;
- Ndaj **pushtetit lokal**, janë paraqitur **26 raste** të dyshuara për veprime korruptive, shprehur në përqindje kjo shifër është 20.96 % e rasteve;
- Ndaj **institucioneve tjera publike** (këtu hyjnë Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, Korporata Elektroenergjetike e Kosovës, Hekurudhat e UNMIK-ut, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit) janë paraqitur **26 raste** apo 20.96 % të rasteve;
- Ndaj **Prokurorive Publike**, Agjensionin ka pranuar **1 rast** të dyshuar, ky rast i shprehur në përqindje përbën 0.83 %.




Fig.1: Pasqyra e rasteve të dyshuara për korrupsion të paraqitura në Agjension, janar-dhjetor 2007

Rastet e proceduara në prokuroritë publike kompetente dhe organet policore

Gjatë vitit 2007, në rastet për të cilat Agjensioni ka qenë kompetent dhe gjithashtu ka konstatuar se ka prova të mjaftueshme, në prokuroritë publike kompetente dhe organet policore janë dërguar **47 raste** të dyshimit për veprime korruptive, pas shqyrtimit paraprak dhe hetimeve administrative të zhvilluara konform legjislacionit në fuqi.

Nga rastet e dërguara në Prokurori për procedim të mëtejshëm penal, të dhënat sipas institucioneve janë si më poshtë vijon:

- ndaj gjyqtarëve janë dërguar në Prokurori për procedim të mëtejshëm **14 raste** ose **30 %**;
- ndaj zyrtarëve të Qeverisë së Kosovës (këtu përfshihen edhe ministrinë në kuadër të saj), janë dërguar në Prokurori **13 raste** të dyshuara ose **28 %** nga totali i rasteve të proceduara;
- ndaj zyrtarëve të pushtetit lokal janë dërguar në Prokurori **11 raste** të dyshuara ose **23 %** e totalit;
- ndaj zyrtarëve të institucioneve tjera publike (Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, Korporata Elektroenergjetike e Kosovës, Hekurudhat e UNMIK-ut, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit), janë dërguar **9 raste**, apo shprehur në përqindje, **19 %**.




Fig.2: Pasqyrë e rasteve të proceduara në prokuroritë publike kompetente gjatë periudhës 1 janar 31 dhjetor 2007

Natyra e rasteve të dërguara në Prokurori

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, përkatësisht Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës, natyra e rasteve sipas veprave penale është si në vazhdim:

- *Shpërdorim i detyrës zyrtare dhe autorizimit –12 raste;*
- *Përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare – 9 raste;*
- *Marrja e ryshfetit - 10 raste;*
- *Ushtrimi i ndikimit – 4 raste;*
- *Nxjerrje e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore –7 raste;*
- *Arkëtim dhe pagesa e paligjshme - 2 raste;*
- *Falsifikim i dokumentacionit zyrtar –3 raste.*

Rastet e mbyllura

Duhet theksuar fakti se të gjitha rastet e paraqitura pranë Agjensionit Kosovar kundër Korrupsionit janë shqyrtuar paraprakisht dhe pasi janë zhvilluar hetimet administrative përkatëse janë mbyllur 61 raste të paraqitura për shkak të:

- a. jo kompetencës së Agjensionit për rastet në fjalë; dhe
- b. për shkak të mungesës së fakteve.

Në disa raste pasi kemi marr informatën nga qytetarët për dyshimet për tejkallim të normave ligjore, Agjensioni ka ndërhyrë dhe pas paralajmërimeve për përgjegjësi penale, ka ardhur deri te kthimi i ligjshmërisë përkitazi me rrethanat objektive të rastit në fjalë.

Rastet në procedurë

Për 16 rastet e mbetura në Agjensionin Kosovar kundër Korrupsionit janë duke u zhvilluar procedurat hetimore dhe varësisht nga rezultati i hetimeve rastet do të përcillem për procedim të mëtejshëm penal apo do të merret vendimi për mbylljen e tyre.

Rastet anonime të paraqitura në AKK

Në zbatim të nenit 16.2 të Ligjit kundër Korrupsionit që i referohet personave të cilët me mirëbesim kanë dhënë informacionin për ekzistencën e rasteve korruptive dhe me qëllim të pengimit të pasojave të dëmshme ndaj tyre, Agjensioni ka bërë të mundur për qytetarët paraqitjen e rasteve të dyshuara apo të informacionit në mënyrë anonime nëpërmjet linjës telefonike pa pagesë **044 082 82** apo përmes raportimit online në faqen zyrtare të internetit të Agjensionit, www.akk-ks.org

Gjatë periudhës raportuese, departamenti ka pranuar një numër të madh të informacioneve anonime për vepra korruptive ku:

- a) numri i përgjithshëm i informacioneve anonime që ka pranuar Agjensioni është 24 raste;
- b) numri i rasteve të proceduara në prokurorinë publike kompetente është 17 raste; dhe
- c) 7 raste janë ende nën procedurë hetimore.

Pasqyra e përgjithshme e rasteve të paraqitura në AKK

Numri i rasteve të paraqitura, rasteve të mbyllura, rasteve të proceduara në prokurorinë publike kompetente dhe organet policore dhe rasteve të mbyllura në mënyrë tabelare duken si më poshtë, shih fig. 3:

Institucioni	Rastet e paraqitura	Rastet e mbyllura	Rastet e dërguara në prokurori	Rastet në procedurë
Qeveria	36	15	13	8
Parlamenti	/	/	/	/
Gjykatat	35	19	14	2
Prokuroritë	1	1	/	/
Institucionet e tjera	26	13	9	4
Pushteti lokal	26	13	11	2
GJITHSEJT	124	61	47	16

Tabela A: Pasqyrë e përgjithshme e rasteve të paraqitura dhe të proceduara nga AKK gjatë periudhës janar – dhjetor 2007

Informata të proceduara në institucionet përkatëse	Numri	Të hedhura poshtë	Nën hetime
Prokurorinë Publike të Prishtinës	21	1	20
Prokurorinë Publike të Mitrovicës	1	/	1
Prokurorinë Publike të Pejës	5	1	4
Prokurorinë Publike të Prizrenit	5	4	1
Prokurorinë Publike të Gjilanit	2	/	2
Prokurorinë Publike Speciale	3	/	3
SHPK	8	/	8
Policia e UNMIK-ut	1	/	1
FIU	1	/	1
GJITHSEJ	47	6	41

Tabela B: Pasqyrë e përgjithshme e rrjedhës së informatave të paraqitura në institucionet përkatëse

Për informatat që janë dorëzuar në Prokurori ne në mënyrë zyrtare jemi informuar për fatin e vetëm 6 prej tyre, informatat kanë të bëjnë me institucionin e gjyqësorit në 5 raste dhe një nga Pushteti Lokal, befason "shpejtësia" e prokurorive që rastet të cilat i përkasin gjyqësorit ti hedhë shume shpejt dhe për këtë të informoi menjëherë (1 informatë është kthyer në AKK vetëm për 10 dite).

Pasojat e korrupsionit në shifra

Siç dihet, pasojat që i shkakton korrupsioni një vendi janë të shumta dhe të shumëfishta, ndër to përmendim pasojat ekonomike, politike, ligjore por para së gjithash ato zbehin besimin e qytetarëve në institucionet demokratike.

Gjatë punës së kryer nga AKK-ja brenda një vitit, nga një llogari e thjeshtë ekonomike mbi faktet e sjella nga rastet e dyshuara për veprime korruptive të cilat i janë përcjellë për procedim penal të mëtejshëm në prokuroritë përkatëse, pasojat ekonomike që llogaritet ti kenë ardhur shoqërisë kosovare, rezultojnë të kapin shifrën prej 30 milion, për të dy sektorët: sektorin publik dhe atë privat, respektivisht:

- a. në sektorin publik dëmet e shkaktuara kapin shumën rreth 28,000,000.00 (njëzet e tetë milion) Euro, ndërsa
- b. në sektorin privat dëmet e shkaktuara llogaritet të jenë rreth 2,000,000.00 (dy milion) Euro.

Ofrimi i këshillave ligjore për qytetarët

Departamenti i Hetimeve ka ofruar edhe këshilla të konsiderueshme ligjore për qytetarët e ndryshëm të cilët i janë drejtuar Agjencionit për paraqitjen e ankesave të tyre. Në këto raste Departamenti i Hetimeve duke mos qenë kompetent që vetë ti zgjidh këto raste, u ka dhënë qytetarëve këshilla ligjore dhe udhëzime për adresimin e ankesave të tyre tek institucionet kompetente.

ii. Iniciativat Legjislative

- a. Departamenti i Hetimeve ka dhënë kontributin e nevojshëm profesional në përgatitjen e Projektligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Funkcionin Publik përmes pjesëmarrjes në Grupin Punues Qeveritar. Ky Projektligj është iniciuar nga Ministria e Shërbimeve Publike.

- b. Është studiuar legjislacioni anti-korrupsion i vendeve të rajonit si dhe vendeve të tjera evropiane dhe është përgatitur Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Kundër Korrupsionit i cili është shpallur në fuqi me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/26. Ky Projektligj do të procedohet sipas procedurës së paraparë për shqyrtimin dhe aprovimin e projektligjeve në Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës.
- c. Departamenti i Hetimeve gjatë periudhës raportuese ka zhvilluar një aktivitet të rëndësishëm në drejtim të përgatitjes së akteve të brendshme rregullative për punën e AKK-së. Në këtë drejtim janë përgatitur 22 Projekt – Vendime për nënshkrim nga ana e Drejtorit të AKK-së si dhe është dhënë ndihmë e nevojshme profesionale juridike në përgatitjen e Rregullave Procedurale për Punën e Këshillit të AKK-së dhe në përgatitjen e Rregullave Procedurale të AKK-së. Gjithashtu zyrtarët e Departamentit të Hetimeve kanë marrë pjesë në disa mbledhje të Këshillit të AKK-së duke ofruar konsulencën e nevojshme profesionale juridike për shqyrtimin dhe aprovimin e dy Rregullave Procedurale: të Këshillit dhe të AKK-së.
- d. Departamenti i Hetimeve ka marrë pjesë deri më tani në disa debate publike të iniciuara nga MSHP-ja në lidhje me përgatitjen e Projektligjit për Shërbimin Civil në Kosovë duke dhënë komentet dhe propozimet ligjore të nevojshme në pasurimin e materies ligjore të propozuar.

iii. Edukimi dhe ngritja e vetëdijes së publikut

Të dhënat e mëposhtme paraqesin në mënyrë të detajuar, pjesëmarrjen e Departamentit të Hetimeve në disa prej aktiviteteve të larmishme të zhvilluara gjatë harkut kohor të një viti:

- ✓ Si rezultat i bashkëpunimit të shkëlqyer me Qendrën për Arsim të Kosovës (KEC), departamenti ka marrë pjesë aktivisht në 10 seminare të organizuara në 10 komuna të Kosovës: Drenas, Gjilan, Istog, Rahovec, Mitrovicë, Suharekë, Prishtinë, Prizren, Skenderaj dhe Gjakovë. Në këto seminare pjesëmarrësit janë njohur me punën e kryer për Strategjinë kundër Korrupsionit, Planin e Veprimit kundër Korrupsionit, Ligjin kundër Korrupsionit si dhe mandatin ligjor e aktivitetet e Agjensionit Kosovar kundër Korrupsionit. Në kuadër të këtij organizimi, ky aktivitet është prezantuar edhe në dy stacione televizive lokale në Mitrovicë dhe në Gjakovë ku tek teleshikuesit është prezantuar gjerësisht aktiviteti i Agjensionit. Programi në fjalë është dizajnuar në mënyrë që përmes tij të bëhet përcjellja e temave për fenomenin e korrupsionit nga arsimtarët dhe profesorët tek nxënësit e shkollave fillore si dhe atyre të mesme të Kosovës, ku në fund të ciklit të seminareve është arritur përfundimi që në të ardhmen tu propozohet organeve të arsimit për futjen në programet arsimore tema që kane të bëjnë me korrupsionin dhe pasojat e tij. Pjesëmarrës në këto takime kanë qenë edhe këshilltarë nga kuvendet komunale si dhe përfaqësues nga komuniteti i biznesit të cilët janë informuar mbi kuadrin ligjor dhe politikat anti-korrupsion;
- ✓ Pjesëmarrja aktive në realizimin dhe shpërndarjen e informacionit të dy fushatave për vetëdijesimi e ekzistencës të Agjensionit si institucion i ri organizuar në dhjetor 2006 dhe mbi punën e bërë për rastet korruptive të raportuara nën logon “Korrupsioni mbaron me ju - inico rastin tjetër” të realizuar në shtator 2007. Në vazhdim, departamenti ka marrë pjesë në konceptimin e idesë për fushatën e radhës që do të mbahet në shkurt – mars 2008 tek nëpunësit publik me moton “Unë nuk jam i/e korruptuar” si dhe do

të jetë pjesë përbërëse e saj në organizimin e takimeve me nëpunësit civil dhe njëkohësisht shpërndarjen e materialeve;

- ✓ Pjesëmarrja në takimet e standardit "Sundimi i ligjit" të organizuara nga Ministria e Drejtësisë në të cilat është raportuar gojarisht dhe me shkrim për aktivitetet e AKK-së në drejtim të zbatimit të këtij standardi;
- ✓ Pjesëmarrja në takimin e 12-të të Mekanizmit të Stabilizim Asociimit të organizuar në Prishtinë nga Qeveria e Kosovës dhe Komisioni Evropian në të cilin takim u prezantuan aktivitetet, planet për të ardhmen dhe sfidat në realizimin e mandatit ligjor të AKK-së;
- ✓ Pjesëmarrja dhe prezantimi në dy seminare të organizuara nga projektet e BE-së për fuqizimin e kapaciteteve kosovare në luftimin e pastrimit të parasë dhe korrupsionit;
- ✓ Gjithashtu departamenti ka marrë pjesë edhe në një numër takimesh zyrtare, seminaresh dhe organizimesh të tjera të ngjashme të organizuara nga institucionet e tjera dhe që si tematikë të tyre kanë pasur luftën kundër korrupsionit.

VI. AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT TË PARANDALIMIT TË KORRUPSIONIT

Gjatë periudhës njëvjeçare, departamenti duke u bazuar në mandatin që i është dhënë me Ligjin kundër Korrupsionit dhe Rregullave të Brendshme Procedurale të AKK-së dhe Rregullave për Organizimin dhe Sistemimin e Agjensionit, ka zhvilluar një aktivitet të larmishëm me qëllim të realizimit të obligimeve që dalin nga aktet ligjore të theksuara më lart.

Duhet theksuar se gjatë realizimit të aktiviteteve të veta departamenti ka hasur në vështirësi të theksuara që lidhen kryesisht me mungesën e numrit adekuat të të punësuarve në këtë departament, meqenëse aktualisht janë vetëm tre të punësuar nga nëntë të parashikuar në organogramin e institucionit si dhe mungesa e krijimit të bazës së të dhënave e infrastrukturës së nevojshme për këtë departament, pengesat që reflektohen nga mungesa e stimulimit dhe mbështetjes adekuate për angazhimet specifike në drejtim të realizimit të detyrave përkatëse.

Detyrat e këtij departamenti janë të fokusuara në mbikëqyrjen e pasurive të zyrtarëve të lartë publik, parandalimin e konfliktit të interesit dhe mbikëqyrjen e pranimit të dhuratave të regjistruara në institucionet publike, duke e përqendruar kështu misionin e këtij departamenti në aspektin parandalues.

i. Mbikëqyrja e Pasurive

Duke u bazuar në nenin 39 të LKK-së, Agjensioni mbikëqyr pasurinë e personave zyrtar të lartë në bazë të informacionit të dorëzuar nga personi zyrtar i lartë në një formular të posaçëm, i cili është përcaktuar nga Agjensioni.

Duke vepruar konform dispozitave ligjore të LKK-së, gjatë muajve të parë të vitit 2007, Agjensioni përcaktoi Formularin për Deklarimin e Gjendjes së Pasurisë së Personave Zyrtar të Lartë. Sipas dispozitave ligjore të LKK-së, formularët e plotësuar duhet të dorëzohen pranë Agjensionit, deri më 31 mars, për vitin paraprak.

Departamenti ka filluar punën me shpërndarjen e formularëve tek të gjithë zyrtarët e lartë në institucionet qendrore me datën 1 mars 2007. Në bazë të listave të cilat janë paraqitur nga institucionet përkatëse, janë evidentuar 732 zyrtarë të lartë të cilët janë të obliguar të bëjnë deklarin e pasurisë. Në përfundim të afatit ligjor të përcaktuar me ligj deri me datën 31 mars 2007, këtij obligimi i janë përgjigjur 67.07% e zyrtarëve të lartë publik nga 732 persona gjithsej.

Në pajtim me nenin 43.1 të Ligjit kundër Korrupsionit, dispozitë e cila parashikon rastin se nëse formulari nuk dorëzohet nga zyrtari i lartë sipas afatit kohor të përcaktuar në ligj, Agjensioni ka të drejtën të nxjerrë një paralajmërim dhe të vendos një afat të ri i cili nuk mund të jetë me i shkurt se 15 ditë.

Në vijim të kësaj dhe për të pasur një reagim të shpejtë dhe efektiv, departamenti pasi kreu verifikimin e listave të zyrtarëve të cilët nuk kishin dorëzuar formularët, me datë 11 prill 2007 nxori një paralajmërim dhe vendosi si afat të ri, datën 4 maj 2007, për deklarin e pasurisë për zyrtarët e lartë të cilët nuk kanë deklaruar pasurinë deri me 31 mars 2007. Gjendja e deklarimeve pas afatit të ri, arriti në 94.4 %, por paraqitja e formularëve vazhdoi dhe pas kësaj date.

Në të gjitha rastet kur zyrtari i lartë nuk ka përbushur detyrimin ligjor brenda afateve kohore të përcaktuara në ligj e të informuara nga Agjensioni, departamenti ka njoftuar eprorët e institucioneve ku punon zyrtari, ku ka kërkuar ndërmarrjen e masave administrative të zvogëlimit të pagës mujore me një të pestën e shumës së përgjithshme derisa zyrtari të dorëzojë formularin. Numri i zyrtarëve të lartë, ndaj të cilëve është kërkuar që të merret kjo masë ndëshkuese ka qenë 21 sosh.

Meqenëse edhe pas këtyre afateve të njëpasnjëshme, ka raste të zyrtarëve të lartë që nuk e kanë deklaruar pasurinë e tyre, në pajtim me nenin 43.3 kemi kërkuar nga organi ku zyrtarët punojnë, që të fillojnë procedurat e shkarkimit për mos përbushje të obligimit ligjor.

Emrat e zyrtarëve të lartë që nuk e kanë deklaruar pasurinë janë nga Kuvendi i Kosovës dhe nga Gjykatat Komunale:

1. Slagjan Iliq-Deputet
2. Oliver Ivanoviq-Deputet
3. Vesna Jovanoviq-Deputete
4. Goran Bogdanoviq-Deputet
5. Rangjel Nojkiq-Deputet
6. Sabit Rrahmani-Deputet
7. Sasha Gjokiq-Deputet
8. Gojko Saviq-Deputet
9. Ixhlale Sheholli-Gjykata Komunale/Prishtinë
10. Dejan Miliq- Gjykata Komunale/Mitrovicë
11. Javorka Priliqeviq- Gjykata Komunale për Kundërvajtje/Shtërpce
12. Suzana Kojiç- Gjykata Komunale për Kundërvajtje/Pejë
13. Reshat Karanxha- Gjykata Komunale për Kundërvajtje/Prizren
14. Ibrahim Rexhepi- Gjykata Komunale për Kundërvajtje/Mitrovicë

Lidhur me gjendjen e përgjithshme të procesit të deklarimeve të pasurisë, kemi Tabelën A, ku jepen në mënyrë të detajuar përqindjet e zyrtareve të lartë që kanë deklaruar pasurinë, të ndarë në bazë të institucioneve.

Institucionet	Numri i zyrtareve të lartë të obliguar për deklarimin e pasurisë	Pozitat e paplotësuara ²	Numri i zyrtareve të lartë që kanë deklaruar pasurinë	Numri i zyrtarëve që nuk e kanë deklaruar pasurinë	Përqindja e deklarimit (%)
Kuvendi	123	1	114	8	92.6
Presidenca	4	-	4	0	100
Qeveria	202	4	198	0	98.0
Gjykatat	316	-	310	6	98.1
Prokuroria	87	-	87	0	100
Totali	732	5	713	14	98.0

Tabela A: Pasqyrë e përgjithshme mbi deklarimet e pasurisë deri në fund të vitit 2007

Gjithashtu, në bazë të detyrimit ligjor që Agjensioni duhet ti paraqesë Këshillit të Agjencionit pasuritë e personave zyrtarë që punojnë në Agjension. Pasi ai është organi i cili i mbikëqyr këtë të fundit, gjatë muajit maj, departamenti ka përmbyllur edhe procesin e deklarimit të pasurisë nga ana e të punësuarve në AKK, përkatësisht janë paraqitur deklarimet e 15 zyrtareve para Këshillit të Agjencionit.

Në kontekstin e mirë të menaxhimit të Departamentit në përgjithësi dhe divizioneve të tij në veçanti, gjatë këtij viti për të cilin po raportojmë është punuar në krijimin e një baze të dhënash për deklarimet e pasurive, çfarë ka bërë të mundur krijimin e dosjeve individuale për të gjithë zyrtarët e lartë publik në bazë të institucioneve përkatëse dhe sistemimin e informacioneve përkatëse në to. Kjo bazë do ti shërbej Departamentit dhe Agjencionit në përgjithësi për kryerjen me efikasitet të aktiviteteve që lidhen me procesin e deklarimit të pasurisë, hetimit të ekzistencës së konfliktit të interesave dhe në kryerjen e detyrave të tjera që dalin nga mandati i AKK-së.

Gjithashtu, është në proces edhe konsolidimi i bazës elektronike të të dhënave, e cila me kompletimin e Agjencionit me zyrtarin/enë e teknologjisë informative do të arrihet që të modernizohet dhe të freskohet vazhdimisht me të dhëna në kohë reale.

Sa i përket, hartimit të Projektligjit për Deklarimin e Prejardhjes së Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë, iniciativë kjo e marrë nga Ministria e Drejtësisë, që mundëson hartimin e një ligji të veçantë për deklarimin e mbi të gjitha kontrollin e prejardhjes së pasurisë së zyrtarëve të lartë, departamenti ka dhënë ndihmësen e tij profesionale e ligjore në Grupin Punues.

ii. Kontrolli i Formularëve të Deklarimit të Pasurive

Gjatë këtij viti zyrtarët e departamentit kanë përfunduar edhe procesin për shqyrtimin dhe kontrollin e formularëve mbi deklarimin e gjendjes së pasurisë, në kuptim të përmbushjes së rregullt të formularit, të plotësimit adekuat dhe në bazë të kërkesave që dalin nga formulari.

² Pozitat në fjalë janë lajmëruar si të paplotësuara ende me zyrtar të lartë publik apo janë në proces të plotësimit.

Pas kontrollit teknik/logjik shihet se të 365 apo 49% e formularëve ka mungesa në mënyrën e të plotësuarit. Në 232 raste apo 31% të rasteve nuk janë deklaruar të hyrat vjetore. Në 84 raste apo 11% e rasteve nuk është deklaruar informacioni i nevojshëm rreth pasurisë së paluajtshme, ndërsa në 48 apo 6.5 % të rasteve ka mungesë informacioni rreth parave të gatshme dhe pasurisë së luajtshme.




Tabela B: ofron të dhëna në formë grafike lidhur me kontrollin e formularëve

Duke parë mangësitë e shumta që ka pas formulari, e duke menduar për vështirësitë që mund të hasin zyrtarët gjatë procesit të mbushjes së tij, e duke theksuar se ky është formulari i parë i përdorur, departamenti ka menduar të bëjë një thjeshtim të formularit ekzistues, si dhe në të ardhmen e afërt të hartoj një manual sesi formulari mund të mbushet në mënyrë korrekte, megjithëse asnjëherë nuk ka munguar asistencë nga ana e stafit të departamentit për të gjithë ata zyrtarë të cilët kanë pasur probleme apo pyetje mbi mbushjen adekuate të formularit.

Pas kontrollit teknik/logjik, departamenti ka shqyrtuar formularët për raste specifike dhe se kjo punë bëhet në vazhdimësi, duke shkëmbyer informacione të ndërsjella me institucionet tjera që kanë misionin e përafërt me AKK-ën, në atë mënyrë që të shtohen përpjekjet për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

iii. Konflikti i Interesit

Bazuar në përgjegjësitë e dhëna nga Ligji kundër Korrupsionit që kanë të bëjnë me konfliktin e interesit, janë ndërmarrë veprime të caktuara në pajtim me dispozitat ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit. Këtu duhet pasur parasysh se Departamenti në vazhdimësi i shqyrton formularët e paraqitur të deklarimit të pasurisë për të verifikuar ekzistencën apo jo të konfliktit të caktuar të interesit tek zyrtarët e lartë publik.

Përveç shqyrtimit të formularëve të zyrtarëve të lartë, deri tani Agjensioni ka marrë informata të bazuara për ekzistencën e konfliktit të interesit për 15 zyrtar të lartë publik, dhe me anë të ndërhyrjes së Agjensionit konform

dispozitive ligjore të Ligjit kundër Korrupsionit për parandalimin e konfliktit të interesit, është arritur shmangja nga gjendja e konfliktit të interesit.

Gjithashtu, në ato raste ku janë vërejtur shkelje të Ligjit të Prokurimit Publik në institucionet e Kosovës, departamenti ka ndërmarrë veprime konkrete në fushën e parandalimit të korrupsionit. Nga veprimet e ndërmarra, është rekomanduar anulimi i disa tenderëve dhe iniciativave tjera në IPVQ, para hapjes së ofertave, duke eliminuar diskriminimin e operatorëve të përgjegjshëm ekonomik. Vlera e paralogaritur e tenderëve të anuluar arrin shifrën e 7,000,000.00 (shtatë milion) Euro. Prej tyre afër 5,000,000.00 (pesë milion) Euro i përkasin tenderëve që do të zhvilloheshin në qeveri ndërsa 2,000,000.00 (dy milion) Euro tek institucionet me mision të veçantë (ndërmarrje publike).

Lidhur me iniciativën ligjore të ndërmarrë nga Ministria e Shërbimeve Publike për hartimin e “Projektligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funkcionit Publik”, departamenti ka marrë pjesë aktive në Grupin Punues Ndërmnistror për ta hartuar këtë ligj në mënyrë sa më efektive, të plotë e në linjë me të gjitha standardet ndërkombëtare. Ky është një ligj shumë i rëndësishëm në plotësimin e kuadrit ligjor për parandalimin e luftës kundër korrupsionit.

iv. Pranimi i Dhuratave

Me qëllim të zbatimit të kreut të IV- të Ligjit kundër Korrupsionit që ka të bëjë me pranimin e dhuratave, Departamenti për Parandalimin e Korrupsionit ka marrë masa konkrete, fillimisht për përgatitjen e një katalogu të veçantë për dhurata, ka përgatitur udhëzimet për plotësimin e këtij katalogu, si dhe është në përfundim e sipër procesi i shpërndarjes së katalogut të dhuratave dhe organizimi i konsultave mbi plotësimin e katalogut me pikat kontaktuese nëpër institucione.

Ndërkohë, departamenti po bënë një punë përgatitore për mënyrën se si do të klasifikoj regjistrat e dhuratave që do të vijnë nga institucionet qendrore, jo më vonë se data 31 mars 2008, si dhe po punon në mënyrë intensive mbi mënyrën dhe formën e arkivimit dhe bazës së të dhënave.

VII. AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT TË SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE

Vitin 2007 Departamenti i Shërbimeve Administrative e ka përcjellë me një varg problemesh të natyrës së mirë funksionimit, kryesisht problematike kanë qenë buxheti, numri i pamjaftueshëm i zyrtarëve, kalimi AKK-së në objekt të ri dhe i parapërgatitjes së ambienteve të përshtatshme për punë. Kjo e fundit ka kërkuar si parakusht pajisjen e AKK-së me rrjet funksional interneti, me gjenerator në rastet e mungesës së energjisë, me sigurimin e ngrohjes së ambienteve dhe punë tjera administrative.

Gjithashtu një ndihmëse e madhe për departamentin ka qenë rekrutimi i dy zyrtarëve në fillim të vitit 2007, Shefit të Divizionit për Shërbime të Përgjithshme dhe Asistentes Administrative të cilët kanë rritur cilësinë e kryerjes së angazhimeve të ndryshme në mungesë të stafit të plotë.

i. Buxheti për vitin 2007

Vendimi Nr. 02-2840-1/06 datë 23 dhjetor 2006 i Kuvendit të Kosovës i lejon Agjencionit mjetet buxhetore në vlerë prej 537,600.00 € si dhe numër zyrtarësh prej 35 personash. Mirëpo në fillim të vitit 2007, shuma e alokuar sipas Ligjit për Buxhetin 2007, për Agjencionin ka qenë vetëm në shumën 412, 952.00 €, ne krahasim me buxhetin e miratuar nga Kuvendi për 23.18 % më pak.

PERSHKRIMI	Pagat dhe mëditjet	Mallra dhe shërbime	Shpenzimet komunale	Investimet kapitale	GJITHSEJ
Vendimi i Kuvendit të Kosovës	147,151.00	285,649.00	24,800.00	80,000.00	537,600.00
Ligji për buxhet (i lejuar nga Qeveria)	105,600.00	256,052.00	11,300.00	40,000.00	412,952.00
DIFERENCA	41,551.00	29,597.00	13,500.00	40,000.00	124,648.00

Tabela A: Tregon shumën e aprovuar me vendimin e Kuvendit të Kosovës dhe Ligjit për Buxhet

Si pasojë e këtyre vendimeve, gjatë tre muajve të parë të vitit, AKK-ja kishte probleme serioze në kryerjen e pagesave për arsye të mungesës së zyrtarit për prokurim, zyrtarit për buxhet dhe financa, zyrtarit për zotim (moduli i blerjes dhe modulin e aprovimit) dhe zyrtarit për vlerësimin e pasurisë të cilët janë kyç dhe të domosdoshme për funksionimin e pagesave në kohë.

Duke qenë se Agjensioni u gjend në një situatë të tillë me 8 zyrtarë, institucioni u detyrua ti drejtohej edhe njëherë Qeverisë duke kërkuar nga MEF-i shqyrtimin sërish të vendimit të Kuvendit të Kosovës të datës 23 dhjetor 2006 nr. 02-2840-1/06, e pas paraqitjes së kësaj kërkesë nga ana e Qeverisë u lejuan që të merreshin në punë edhe 7 zyrtarë të tjerë. Aktualisht AKK-ja ka një staf prej 15 zyrtarëve që në fakt janë një numër shumë i vogël për të qenë në funksionalitet të plotë, kurse në linjat buxhetore për mallrat dhe shërbimet, shpenzimet kapitale dhe ato komunale nuk ka pasur ndryshime financiare por kanë mbetur ato që janë lejuar me buxhet.

Përshkrimi	Buxheti	Alokimi	Shpenzimet	Zotuara	Shpenzimet & Zotuara	% e shpenzimeve	% e shpenzimeve dhe zotimeve
Pagat dhe mëditjet	105,600.00	75,600.00	64,292.55	0.00	64,292.55	85.04	85.04
Mallra dhe shërbime	256,052.00	258,352.00	227,207.83	21,764.02	248,971.85	87.95	96.37
Shpenzimet komuna	11,300.00	8,487.26	6,297.68	2,189.58	8,487.26	74.20	100.00
Investimet kapitale	40,000.00	40,000.00	39,158.00	0.00	39,158.00	97.90	97.90
GJITHSEJ	412,952.00	382,439.26	336,956.06	23,953.60	360,909.66	88.11	94.37

Tabela B: Tregon në mënyrë të detajuar shpenzimet ekonomike të lejuara me buxhetin e vitit 2007

Siç shihet deri tek mosrealizimi i buxhetit në kufijtë e planifikuar të rrjedhës së parasë në “paga dhe mëditje”, ka ardhur për shkak të kufizimit të numrit të punëtorëve në 15 e jo sipas planifikimit për 35 punëtor. Kurse në kategoritë tjera ekonomike kemi një realizim të mirë edhe buxheti nuk është realizuar 100% , gjithsesi kemi një realizim mbi 90%. Prandaj duke pasur parasysh mungesën e stafit adekuat mund të konsiderohet si një realizim real.

Për shkak se në fillim të vitit jemi vendosur në një objekt të ri privat të marrë me qëra, shpenzimet komunaleve kanë qenë më të vogla në krahasim me shpenzimet e planifikuara, me që se kemi planifikuar vendosjen në objekt në fillim të vitit, por anulimi i tenderit (prokurimin në atë kohë e ka bërë APP-ja në mungesë të zyrtarit të prokurimit), Agjensioni është vendosur në objektin ku ndodhet dhe sot dy muaj më vonë. Ndërsa, “investimet kapitale” janë realizuar në masën 97.90% të mjeteve të planifikuara.




Tabela B: Paraqet shpenzimet sipas kategorive ekonomike

ii. Zyra e Prokurimeve

Zyra e Prokurimeve në organizimin e brendshëm të Agjencionit nuk është nën përgjegjësinë e Departamentit të Shërbimeve Administrative, por si zyrë e veçantë, megjithatë për efekt të këtij raporti dhe meqenëse detyrat e

kësaj zyre lidhen ngushtësisht me shërbimet, aktivitetet e saj po i paraqesim si nënseksion i Departamentit të Shërbimeve Administrative.

Gjatë vitit 2007, detyrat e zyrës së prokurimeve kanë qenë të fokusuara në këto drejtime:

- Hapja dhe vlerësimi i 1 tenderi të shpallur gjatë vitit 2007;
- Përgatitja dhe shpallja e 5 tenderëve;
- 16 procedura kuotim të çmimeve të shpallura në mjetet e informimit dhe ftesa për kuotim të çmimeve;
- 2 procedura të negocuara pa publikim të njoftimit për kontratë; dhe
- 15 procedura për kontratë me vlerë minimale.

Duhet theksuar fakti se gjatë periudhës së raportimit është anuluar një tender për shkak se Ministria e Shërbimeve Publike ka marrë përsipër kryerjen e procedurës së tenderimit, një procedurë e kuotimit të çmimit si dhe një procedurë për kontratë me vlerë minimale .

PËRSHKRIMI	SHUMA	PËRQINDJA
Blerjet me tender	90,327.85	61.5
Blerjet me kuotim të çmimeve	48,423.47	33.0
Blerjet me procedura me vlerë minimale	8,134.24	5.5
<i>Gjithsej</i>	<i>146,885.56</i>	<i>100.00</i>
Pagesat sipas kontratave afatgjata	78,332.04	0.0
TOTAL	225,217.60	0.0

Tabela D: Aktivitetet e zyrës së prokurimit gjatë vitit 2007

iii. Burimet Njerëzore

Divizioni i Burimeve Njerëzore dhe Përkthimit (shih Aneksin I) është pjesë e Departamentit të Shërbimeve Administrative. Gjatë harkut kohor të një viti, divizioni ka funksionuar vetëm me një zyrtar, çfarë ka penguar në të shumtën e rasteve performancën e duhur të divizionit. Megjithë pengesat e parashtruara divizioni është fokusuar në arritjen e misionit të tij dhe ka bere një punë të kënaqshme në aspektin e trajtimit në kohë dhe me efikasitet të:

- Hapjes së vendeve të reja të punës dhe kryerjes së procedurave transparente për punësimin e zyrtarëve të rinj;
- Përgatitjes së kontratave për stafin e ri;
- Dorëzimin e formularëve për paga;
- Krijimin e një plani trajnimesh për aftësimin e zyrtarëve të Agjencionit si dhe mbajtjen e shënimeve për trajnime dhe organizimin e tyre, etj.

Tabela në Shtojcën 2, tregon me hollësi trajnimet e kryera dhe fushat përkatëse të trajnimit që ka marrë stafi. Duhet theksuar se trajnimet kanë qenë rezultative dhe të gjithë zyrtarët e Agjencionit janë përpjekur që eksperiencat e përfuara prej tyre ti venë në veprim.

Gjithsesi nuk mohohet nevoja e trajnimeve të mëtejshme e të specializuara në fusha të ndryshme, meqenëse Agjensioni ende mbetet një institucion i ri dhe i sapo themeluar.

VIII. ZYRA PËR MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN

Zyra për Marrëdhënie me Publikun, nga momenti i emërimit në punë të zyrtarit të saj në mars 2007 e ka përqendruar punën kryesisht në këto aspekte:

- Takime me gazetarë dhe qytetarë;
- Faqja e re zyrtare e internetit;
- Deklaratat dhe konferencat për shtyp;
- Monitorimi i mediave për periudhën janar - dhjetor 2007; dhe
- Aktivitetet dhe bashkëpunimi.

i. Takime me gazetarë dhe qytetarë

Gjatë gjithë periudhës së funksionimit të Agjencionit ka pasur një interesim të madh si nga ana e komunitetit të gazetarëve por edhe nga ana e publikut për sa i përket iniciativave dhe aktiviteteve të Agjencionit, ku nuk kanë munguar dhe interesimi për të bashkëpunuar ngushtësisht për parandalimin dhe luftimin e këtij fenomeni në shoqërinë kosovare.

Gjatë gjithë vitit 2007 gazetarë sikundër dhe qytetarë të thjeshtë kanë trokitur shpesh në derën e institucioneve me qëllim për të marrë informacione e të dhëna të detajuara se si mund ta ndihmojnë Agjencionin apo bashkëpunojnë me të. Zyrtarët e Agjencionit kanë qenë gjithmonë të gatshëm dhe iu kanë ofruar asistencë të specializuar dhe bashkëpunim në rastet kur ka pasur dyshime të bazuara për raste korruptive.

ii. Faqja e re zyrtare e internetit

Në kuadrin e një projekti dhe nisme të përbashkët me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE) dhe Zyrës së Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNDP) si dhe financim nga ana e këtyre dy organizatave, përgjatë muajve qershor-tetor 2007 është punuar ngushtësisht dhe intensivisht në konceptualizimin dhe finalizimin e një faqe të re zyrtare interneti për Agjencionin e cila u lansua në datën 13 nëntor 2007.

Kjo faqe e internetit për publikun e gjerë është një dritare e informacionit të gjithanshëm mbi aktivitetet, detyrat dhe iniciativat e ndërmarra nga Agjencioni. Të gjithë të interesuarit që duan ta përdorin këtë faqe tani kanë mundësi të marrin informacion për aktivitete të cilat janë në zhvillim e sipër, ato që janë mbajtur më përpara e cilat do të mbahen në të ardhmen, përmes një përshkrimi shumë profesional të detajuar dhe në kohë reale. Jo vetëm po aty mund të gjenden informacione e dokumente politikash jo vetëm të publikuara nga Agjencioni por dhe të mekanizmave të tjerë anti-korrupsion ndërkombëtarë apo rajonal.

Gjithashtu, kjo faqe i ofron publikut mundësinë e raportimit të rasteve korruptive dhe me anë të raportimit online gjithmonë duke ruajtur anonimat e personit i cili dërgon informacionin.

Statistikat e faqes së internetit tregojnë se publiku ka pasur një interesim të shtuar për ta vizituar faqen dhe marrë informacion, megjithëse faqja ka vetëm 2 muaj jetë dhe është ende duke u pasuruar me informacion dhe dokumente.

iii. Deklaratat dhe konferencat për shtyp

Gjate gjithë vitit 2007, Zyra e Marrëdhënieve me Publikun ka luajtur një rol te rëndësishëm në bërjen publike dhe sigurimin e shpërndarjes në të gjithë mediat e shkruar dhe elektronike të komunikatave për shtyp mbi çështje të ndryshme.

Në harkun kohor të një viti janë të shumta deklaratat për shtyp për informimin e gjerë të publikut ku mund të përmendim shkurtimisht: dy deklaratat për shtyp te datave 10 prill 2007 dhe 7 maj 2007 kanë pasur shumë jehonë si në median e shkruar dhe atë vizuale në paraqitjen e gjendjes së saktë mbi deklaratimet e kryera nga zyrtarët e lartë nëpër institucionet qendrore; më 14 nëntor 2007, AKK i bëri një apel publik lidhshëm për bashkëpunim me qytetarët si dhe inkurajimin e tyre për ta luftuar korrupsionin më 9 dhjetor 2007 në ditën ndërkombëtare kundër korrupsionit u publikua një editorial i cili pati jehonë në të gjitha mediat e shkruara të Kosovës, ku theksohej qëndrimi i Agjencionit në luftën e përshtur kundër korrupsionit dhe masat që duhet marrë nga institucionet kosovare në përgjithësi për ta luftuar këtë fenomen; dhe së fundmi në datën 28 dhjetor 2007 u botua një editorial i cili përmbante në pika të shkurta disa nga arritjet e AKK-së në luftën kundër korrupsionit gjatë vitit 2007 si dhe një thirrje për lidhshëmin e ri kosovar që lufta kundër korrupsionit në Kosovën e pas statusit e gjatë vitit 2008 të jetë prioritet numër një.

Gjithashtu janë organizuar dhe 3 konferenca për shtyp, njëra daton në ditën e shpalljes publike të Agjencionit, e dyta në datën 20 korrik 2007, kur Agjensioni bëri publik raportin gjashtë mujor të punës për Këshillin e Agjencionit dhe e treta, daton në 3 shtator 2007, ditën kur u lansua fushata kombëtare për informim dhe sensibilizim për rritjen e bashkëpunimit me publikun, dhe rritjen e besimit të tyre në punën e Agjencionit si dhe shtimin e numrit të rasteve të raportuara.

Gjithashtu, Zyra për Marrëdhënie me Publikun në çdo moment ka qenë e gatshme për t'iu përgjigjur në mënyrë profesionale kërkesave të ndryshme që vijnë nga gazetarë apo media mbi iniciativat ose detyrat e Agjencionit.

iv. Monitorimi i mediave ne periudhën janar - dhjetor '07

Sipas asaj që është shkruar për AKK-në del se mediat kanë shkruar shumë pozitivisht për nismat e ndërmarra e aktivitetet e kryera. Për punën dhe ta arriturat është shkruar gjerësisht dhe gjithmonë mediat i kanë dedikuar hapësirën e duhur AKK-së për punën në luftën kundër korrupsionit.

Duke pasur parasysh faktin se sa rol me rëndësi luan media në promovimin e përpjekjeve anti-korrupsion dhe demaskimin e rasteve korruptive, si reflektim i një bashkëpunimi të ngushtë me median e cila i ka ardhur në ndihmë Agjencionit jo vetëm në bërjen gjerësisht publike të aktiviteteve të tij por edhe në denoncimin e shumë rasteve korruptive, Shtojca 3 jep një listë të përmbledhur në mënyrë kronologjike të shkrimeve mediatike gjatë vitit 2007.

v. Aktivitete dhe bashkëpunimi

Siç u përshkrua dhe më lart bashkëpunimi me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE) dhe Programin e Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP) në kuadrin e projektit të ndërgjegjësimit të gjerë të publikut mbi punën e Agjencionit Kosovar kundër Korrupsionit dhe luftën kundër korrupsionit një

seminar me titull "Roli i mediave në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit u zhvilluar në datën 27 qershor 2007.

Gjatë këtij seminari janë diskutuar format e bashkëpunimit me gazetarë hulumtues që merren me fushën e korrupsionit, janë trajtuar çështje të kuadrit ligjor dhe mekanizmave në luftën kundër korrupsionit në vend, janë shtjelluar dhe diskutuar kompetencat e AKK-së, paraqitur aktivitete dhe arritje të ndryshme, etj. Gjatë diskutimeve në këtë aktivitet është kërkuar me ngulm nga ana e gazetarëve se Agjensioni duhet të bëjë të gjitha përpjekjet që projekt ligji i ri për deklarimin e pasurive të këtë si pjesë përbërëse dhe bërjen transparente të deklarimeve.

Duhet theksuar dhe puna e përbashkët e Zyrës për Marrëdhënie më Publikun dhe Departamentit për Strategjinë Anti-korrupsion dhe Hetimet Administrative në hartimin dhe më pas zbatimin e fushatës ndërgjegjësuese e cila u mbajt për tre jave rreth nga datat 3-21 shtator në të gjithë territorin e Kosovës si dhe në ideimin e fushatës së re që do të mbahet me nëpunësit civil nën moton "Unë nuk jam i/e korruptuar".

Agjensioni në bashkëpunim më OSBE-në, UNDP-në dhe Asociacionin e Gazetarëve Profesionist të Kosovës (AGPK) ka organizuar në ditën ndërkombëtare të luftës kundër korrupsionit dhe dhënien e çmimit të vitit për gazetari hulumtuese në fushën anti-korrupsionit, të ndarë në tre kategori: historia më e mirë televizive, historia më e mirë në mediat e shkruara, dhe historia më e mirë në radio.

VIII. PROBLEMET E NDESHURA

Megjithë përpjekjet e mëdha dhe të vazhdueshme të Agjencionit për të funksionuar normalisht dhe në kushte problematike gjatë gjithë vitit 2007, institucioni ia ka dalë mbanë të kryej një larmishmëri detyrash dhe aktiviteteve. Gjithsesi nuk ka munguar dhe përballja me probleme të ndryshme të natyrës substanciale të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në realizimin e disa synimeve dhe që shtjellohen si më poshtë vijon:

Buxheti - Buxheti i Agjencionit në dy vitet që lamë pas nuk është miratuar nga Kuvendi sipas kërkesave të paraqitura nga Agjensioni. Një diferencë e madhe ka ekzistuar midis buxhetit të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës dhe Ligjit për Buxhetin të vitit 2007. Ky buxhet i limituar ka bërë që Agjensioni të hasi në pengesa të mëdha funksionale. Është e një rëndësie të veçantë të përmendet fakti se dhe aktet ndërkombëtare në luftën kundër korrupsionit theksojnë fuqimisht së një institucion qendror dhe i suksesshëm në parandalimin e luftën kundër korrupsionit duhet të jetë tërësisht i pavarur dhe të ketë anën financiare të mjaftueshme për funksionimin normal të tij.

Numri i vogël dhe i pamjaftueshëm i personelit - Numri i vogël i zyrtarëve dhe pamundësia e rekrutimit të personelit shtesë si rezultat i buxhetit të limituar ka qenë problem thelbësor në përmbushjen e plotë të misionit të institucionit.

Mungesa e zyrtarëve ka ndikuar edhe në numrin e rasteve të hetuara. Vetëm katër zyrtarë të këtij departamenti kanë arritur të hetojnë 124 raste të dyshuara për korrupsion ku 47 prej tyre janë dërguar në Prokuroritë e Kosovës. Në të njëjtën kohë të njëjtët zyrtarë janë angazhuar në grupe punuese në hartimin e ligjeve të fushës (të përmendura në aktivitetet e departamenteve) si dhe në shumë tryeza, takime, trajnime, fushata e aktivitete të tjera edukuese.

E njëjta situatë paraqitet në Departamentin për Parandalimin e Korrupsionit ku shumë informata kanë mbetur pa u trajtuar si dhe shumë deklarata të pasurisë kanë mbetur pa u analizuar.

Mungesa e madhe e zyrtarit të teknologjisë informative është shkak kryesor i shpenzimeve të shumta, pasi na është dashur të angazhojmë zyrtarë nga institucionet tjera. Ajo c'ka është më me rëndësi është fakti se sigurimi i të dhënave në Agjension cdo ditë e më shumë po rrezikohen. Institucioni zotëron të dhëna konfidenciale të cilat duhen mbrojtur, ndërkaq rreziku i mundësisë së qasjes nga jashtë në këto të dhëna është shumë i madh dhe emergjent pasi ato mund të përdoren kundër nesh dhe interesit të përgjithshëm, ose të fshihen një herë e përgjithmonë.

Për përkthimin e materialeve të ndryshme apo dokumenteve me rëndësi në gjuhën angleze dhe/apo në gjuhën serbe kemi shpenzuar më shumë mjete sa që do t'i kishim shpenzuar për pagat vjetore të dy zyrtarëve gjatë këtij viti. Mungesa e vozitësit dhe shpërndarësit të postës krijon po ashtu probleme dhe jo-efikasitet. Për realizimin e këtyre detyrave përcjellëse janë angazhuar zyrtarë të tjerë, gjë që ul ndjeshëm rendimentin në punë.

Pagat - Niveli i pagave të stafit në Agjension është jo stimulues dhe aspak motivues për ekspertë të kësaj fushe. Stafi i këtij institucioni të rëndësishëm, duhet të stimulohet dhe pozicionet e veçanta të tij të kategorizohen për kompensim për rrezikshmëri në punë.

Rreziku i largimit të personelit ekzistues – Një rrezikshmëri permanente për Agjensionin e cila ka lidhje të ngushtë me pagat është edhe mundësia e largimit të zyrtarëve ekzistues nga Agjensionin, megjithëse për ngritjen profesionale të tyre Agjensionin ka mobilizuar të gjitha mundësitë.

Mundësia e largimit të zyrtarëve që në mënyrë direkte janë të kyçur në fazën e hetimeve të dyshuara për korrupsion e rrezikon edhe funksionimin e AKK-së si tërësi. Shembull përbën largimi i një zyrtari të lartë, i cili pas më shumë se një vit në Agjension për shkaqe financiare kaloi në KEK, pasi rroga mujore është disafish më e madhe së ajo që i ofronte pozicioni në AKK.

Koordinim jo i kënaqshëm me Prokuroritë – Brenda vitit nga prokuroritë për 47 informata që i kemi përcjell kemi marrë konfirmimin e hedhjes se 6 informatave edhe ato 5 që i përkasin informatave ku pretendojmë se veprimet korruptive janë nga gjyqësori dhe 1 informatë nga pushteti lokal, për fatin e 41 informatave tjera nuk kemi informata.


Mungesa e hapësirës - Në mungesë të objektit publik, AKK-ja e realizon veprimtarinë e vet në një objekt privat, me hapësirë të vogël e ku kushtet janë minimale edhe për pesëmbëdhjetë zyrtarët, që aktualisht janë të punësuar në Agjension (përfshi këtu dhe katër këshilltarët që ofrojnë asistencë teknike).

Gjatë këtij viti, bazuar në Ligjin mbi Buxhetin 2008, në Agjension do të punësohen dhe 20 zyrtarët e tjerë, e ndërkaq hapësira e tanishme nuk do të lejon komoditetin e nevojshëm për kryerjen normale të punës, klasifikimin e arkivimit e dokumenteve, ambjenteve të vecanta për raportimet anonime të qytetarëve, etj.

Për sa i përket aspektit të sigurisë, objekti mbrohet nga një kompani e sigurimeve private e paarmatosur e cila nuk garanton sigurinë e nevojshme për stafin e AKK-së, për të mos përmendur këtu së institucionit nuk i është siguruar një aparat për dedektimin e metaleve e armëve.

IX. SFIDAT E SË ARDHMES/PLANET

Disa nga planet dhe prioritetet që priten të realizohen gjatë harkut kohor të vitit 2008 janë:

 *Rritja e nivelit dhe fuqizimi i bashkëpunimit me institucionet që kanë për mision luftën kundër korrupsionit*

Agjensioni vazhdimisht do të kultivojë marrëdhënie të mira bashkëpunimi me institucionet vendore e ndërkombëtare që kanë për mision luftën kundër korrupsionit si dhe do të shtojë përpjekjet e përbashkëta me qëllim rezultate reale në çrënjosjen e korrupsionit në Kosovë.

 *Ngritja dhe përmirësimi i kapaciteteve hetuese*

AKK-ja synon të rrisë në maksimum kapacitetet hetuese. Kjo nënkupton rekrutimin në një periudhë të shkurt kohore të stafit të ri në Departamentin për Strategjinë Anti-korrupsion dhe Hetimet Administrative, pajisjen me teknologji përkatëse të sofistikuar, trajnimin e specializuar të stafit, etj.

 *Zbatimi i kuadrit ligjor anti-korrupsion*

Vazhdimisht AKK-ja do të jetë e përkushtuar në zbatimin korrekt të kuadrit ligjor anti-korrupsion si dhe të bëhet i mundur krijimi i mekanizmave të duhur për zbatimin sa më të mirë të kësaj baze ligjore.

 *Përgatitja e strategjisë kombëtare kundër korrupsionit*

Agjensioni do të ketë si një prioritet të tij urgjent, hartimin dhe vënien në zbatim në bashkëpunim dhe koordinim me partnerët e tjerë të një strategjie dhe plani veprimi anti-korrupsion në nivel qendror dhe lokal me masa reale dhe që do të kenë impakt në shoqërinë kosovare.

 *Intensifikimi i përpjekjeve për edukimin dhe pjesëmarrjen e publikut në nismat anti-korrupsion*

Hartimi dhe zbatimi i një plani specifik takimesh dhe trajnimesh me sektorin publik dhe atë privat, shoqërinë civile, mediat, moshën e tretë, studentët, etj për të rritur bashkëpunimin me publikun e gjere dhe ndërgjegjësimin për rolin pozitiv e të ndërsjelltas Agjension-publik. Vazhdimi i disa fushatave sensibilizuese.

 *Pranimi i zyrtarëve të rinj*

Kjo do të bëhet e mundur pas miratimit të buxhetit nga ana e Kuvendit të Kosovës. Agjensioni me përpikëri do të respektojë kriteret e duhura dhe do të tregojë profesionalizëm gjatë procesit të rekrutimit të stafit të ri.

 *Ngritja profesionale e zyrtarëve aktual dhe të rinj të AKK-së*


Do të mundësohen dhe organizohen takime dhe trajnime të specializuara të njëpasnjëshme jo vetëm në Kosovë për tema të caktuara por edhe takime me agjensi apo institucione që kanë mision të njëjtë me Agjensionin për marrje dhe shkëmbim eksperience.

X. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Ne nuk e kemi ndjenjën e të privilegjuarit pasi që gjatë gjithë punës sonë në drejtim të përmbushjes së misionit jemi ballafaquar me situata të vështira dhe shumë herë edhe të rrezikshme. Përkundër këtyre vështirësive me mund të madh është arritur funksionaliteti dhe ngritja e AKK-së në një institucion të respektuar nga qytetarët me mision dhe vizion të qartë – luftën kundër korrupsionit.

Stafi aktual ka demonstruar vazhdimisht gatishmëri që të sfidojnë çdo rast që pretendohet të jetë veprim korruptiv. Që nga themelimi i AKK-së ka pasur arritje të mëdha në luftën kundër korrupsionit. Rezultatet e deritanishme që janë përmendur më lartë janë premtuese edhe për të ardhmen. Ne jemi në hapat e parë, lufta kundër korrupsionit duhet të fitohet me strategji guximtare të cilat jemi duke i hartuar. Megjithatë tejkalimi i sfidave mund të bëhet vetëm me mbështetjen e madhe institucionale. Ky do të jetë një garancion i fortë që AKK-ja t'i realizojë detyrat e përcaktuara në ligjin kundër korrupsionit.

SHTOJCA 1: Organigrama



XI. SHTOJCA 2: Lista e trajnimeve

Lloji i Trajnimit	Organizuar nga	Vendi i organizimit
Janar 2007		
Zotues	MEF	Prishtinë, Kosovë
Prokurim	KRPP	Prishtinë, Kosovë
Shkurt 2007		
Moduli i blerjes	MEF	Prishtinë, Kosovë
Mars 2007		
Avancimi i qeverisjes së mire dhe lufta kundër Korrupsionit	Banka Botërore Qeveri Belge OECD	Bruksel, Belgjikë
Prokurim	KRPP	Prishtinë, Kosovë
Mediat dhe menaxhimi i krizave	UNDP OSBE	Prishtinë, Kosovë
Prill 2007		
Përvojat e mësuara në parandalimin e korrupsionit	OSBE Pakti i stabilitetit	Tiranë, Shqipëri
Transparenca kundër Korrupsionit dhe etika në edukim	UNESCO	Ohër, Maqedoni
Maj 2007		
Udhëtim studimor në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive	OSBE AKK	Tiranë, Shqipëri
Edukimi, themelimi dhe monitorimi i strukturave që luftojnë korrupsionin	KEC	Prishtinë, Kosovë
Fuqizimi dhe aftësimi i luftimit të korrupsionit dhe pastrimit të parave në Kosovë	EAR	Prishtinë, Kosovë
Parandalimi i pastrimit të parave	FIC	Vushtrri, Kosovë
Qershor 2007		
Seminar mbi Teknikat e Hetimit Financiar	Zyra Amerikane	Vushtrri, Kosovë
Vizite studimore në Zyrën e Parandalimit dhe Luftimit të Korrupsionit	TAIEX Zyra Letoneze	Riga, Letoni
Politikat dhe Strategjitë kundër korrupsionit	Komisioni Evropian	Prishtinë, Kosovë
Punëtori Sektoriale e STM-it	Agjensioni për Integritet Evropian, Ministria e Drejtësisë MPB	Prishtinë, Kosovë
Korrik 2007		
Pastrimi i parave dhe korrupsionit	Instituti Gjyqësor i Kosovës	Prishtinë, Kosovë
Gusht 2007		
Reforma në Administratën Publike	MSHP	Ohër, Maqedoni
Konferencë në mbështetje të Agjencionit kundër Korrupsionit	OSBE	Prishtinë, Kosovë
Shtator 2007		

Konferenca për parandalimin e krimit financiar, korrupsionit dhe pastrimin e parave	Agjencia Evropiane për Rindërtim	Prishtinë, Kosovë
Takim i Këshillit Zbatues	CAST	Rahovec, Kosovë
Kundër korrupsioni, Procedurat e Prokurimit	CEELL- Institut	Pragë, Ceki
Pastrimi i parave dhe luftimi i terrorizmit financiar	OSCE QMZ, UNODC	Mali i Zi
Vizitë studimore	Komisioni për parandalimin e korrupsionit	Sloveni
Parandalimi i shpëlarjes së parave	FIC	Vushtrri, Kosovë
Akademi Verore	Fondacioni, Aleksandër	Poloni
Tetor 2007		
Konferenca e Etikës në Biznes	Zyra Amerikane	Prishtinë, Kosovë
Vizitë studimore në institucionet që parandalojnë dhe luftojnë korrupsionin në Hollandë	One Europe	Amsterdam, Holandë
Konferenca, transparencë, Llogaridhënia dhe Antikorrupsioni	Zyra për Qeverisje të Mirë, UNDP	Prishtinë, Kosovë
Anti- Korrupsioni	Bashkimi Evropian	Prishtinë, Kosovë
Transparenca dhe Antikorrupsioni në Sistemin Gjyqësor në Kosovë	USAID ARTC	Mitrovicë, Kosovë
Bashkëpunimi i Institucioneve, OJQ-ve dhe qytetareve për parandalimin e Korrupsionit	KEC	Prishtinë, Kosovë
Ekzaminer i Certifikuar kundër Mashtrimeve	USAID	Prishtinë, Kosovë
Nëntor 2007		
Mekanizmi Përcjellës për Procesin e Stabilizim-Asocimit	Zyra e Kryeministrit	Prishtinë, Kosovë
Konferenca vjetore dhe mbledhja e përgjithshme e shoqatës ndërkombëtare të autoriteteve anti-korrupsion	IAACA	Bali, Indonezi

XII. SHTOJCA 3: Lista shkrimeve mediatike gjatë vitit 2007

MUAJI	SHKRIMET
Janar	<ul style="list-style-type: none"> - 26 shkrime kryesisht për raste korruptive ku, gazetarët janë fokusuar në të gjitha institucionet e ndryshme publike; - Komuna e Prishtinës ka qene ne shënjestër te akuzave për afera korruptive po ashtu ministritë janë akuzuar për korrupsion; - Auditimet gjenerale kanë hasur në keqpërdorime nëpër komuna dhe të gjitha ministritë, si dhe organizata COHU ka akuzuar Zëvendës Kryeministrin dhe 5 ministra për marrje pjese ne afera korruptive, me specifikisht për parregullsitë në tenderë nëpër ministri e sidomos në Ministrinë e Drejtësisë, në dogana, PTK dhe shumë institucione tjera.
Shkurt	<ul style="list-style-type: none"> - 16 shkrime për raste korruptive nga institucionet publike; - Shumica e këtyre shkrimeve kanë të bëjnë më me dyshime për korrupsion AKM, po ashtu edhe me keqpërdorime në tenderët e komunave; - Shkrimet tjera kanë të bëjnë me afera korruptive nëpër spitale dhe PTK.
Mars	<ul style="list-style-type: none"> - 4 shkrime të cilat kanë paraqitur ekskluzivisht Agjensionit dhe punën e kryer prej tij; - Është trajtuar çështja e deklarimeve te pasurive dhe nëse do të përfundojë si duhet apo jo.
Prill	<ul style="list-style-type: none"> - 16 shkrime për Agjensionin dhe veprimtarinë e tij; - Pas komunikatës nga Agjensioni për deklarimin e pasurisë, shkrimet kanë qenë të fokusuar rreth deklarimit të pasurive dhe mos deklarimi i pasurive të ministrave dhe të gjithë zyrtarëve në detyra publike. - Shkrimet kanë qenë kryesisht kritike ndaj qeveritarëve te cilët nuk e kanë bërë deklarimin e pasurisë së tyre.
Maj	<ul style="list-style-type: none"> - Gjithsej 13 artikuj në gazeta; - Tri shkrime kanë qenë kritike për punën e AKK-së. OJQ "Çohu" ka akuzuar agjensionin antikorrupsion për fshehjen e pasurive të politikanëve ndërsa Gazeta Epoka e Re ka akuzuar Agjensionin për konflikt interesi brenda Agjensionit; - Pas komunikatës së dytë nga Agjensioni, ku përmenden emrat e atyre që nuk e kanë bërë deklarimin e pasurive, shumica e shkrimeve kanë qenë të fokusura në emrat e personave zyrtarë që nuk e kanë bërë deklarimin e pasurive dhe kanë bërë presion për ta kryer këtë detyrë.
Qershor	<ul style="list-style-type: none"> - Gjatë këtij muaji kanë qenë 10 shkrime mjaft pozitive për AKK-në; - Mediat elektronike dhe ato të shkruara, kanë informuar publikun se AKK-ja për tre muajt e parë të këtij viti i ka kthyer buxhetit 300 mije euro dhe janë arrestuar disa persona zyrtarë; - Shkrimet kanë hedhur idenë për ndryshimin e ligjit të AKK-së, për bërjen publike të pasurisë së zyrtarëve të lartë; - Gazeta Epoka e Re, ka bërë publike harxhimet e karburanteve për institucionet publike, ku AKK-ja zë vendin e fundit në këtë listë sa i përket harxhimeve minimale; - Po ashtu në Infopress i është dhënë hapësirë e madhe punës së AKK në kthimin e 300 mije euro para të keqpërdorura buxhetit të Kosovës.
Korrik	<ul style="list-style-type: none"> - 17 shkrime kryesisht për raste korruptive ku, gazetarët janë fokusuar në të gjitha institucionet e ndryshme publike; - Kryesisht auditivet kane nxjerr shume parregullsi ne institucione TMK , ministri te ndryshme kane qene ne shënjestër te akuzave për afera korruptive - Auditimet gjenerale kanë hasur në keqpërdorime nëpër komuna dhe të gjitha ministritë, si dhe organizata COHU ka akuzuar Zevendes Kryeministrin dhe 5 ministra për marrje pjese ne afera korruptive, me specifikisht për parregullsitë në tendera nëpër ministri e sidomos në Ministrine e Drejtësisë, në dogana, PTK dhe shumë institucione

	tjera.
Gusht	<ul style="list-style-type: none"> - 18 shkrime për raste korruptive nga institucionet publike; - Shumica e këtyre shkrimeve kanë të bëjnë më me dyshime për korrupsion ne gjykata prokurori KEK ,AKM, po ashtu edhe me keqpërdorime në tenderët e komunave; - Shkrimet tjera kanë të bëjnë me afëra korruptive nëpër spitale dhe PTK.
Shtator	<ul style="list-style-type: none"> - 8 shkrime të cilat kanë paraqitur ekskluzivisht Agjensionin dhe punën e kryer prej tij; - Është trajtuar çështja e deklarimeve të pasurive dhe nëse do të përfundojë si duhet apo jo.
Tetor	<ul style="list-style-type: none"> - 12 shkrime për Agjensionin dhe veprimtarinë e tij; - Pas komunikatës nga Agjensioni për deklarimin e pasurisë, shkrimet kanë qenë të fokusuar rreth deklarimit të pasurive dhe mosdeklarimi i pasurive të ministrave dhe të gjithë zyrtarëve në detyra publike. - Shkrimet kanë qenë kryesisht kritike ndaj qeveritarëve të cilët nuk e kanë bërë deklarimin e pasurisë së tyre.
Nëntor	<ul style="list-style-type: none"> - Gjithsej 21 artikuj në gazeta; - Te gjitha shkrimet kanë qenë të fokusuar në ministrin Bujar Dugolli po ashtu edhe korrupsionin nëpër gjykata dhe prokurori. (Më 8 nëntor në të gjitha mediat e shkruara është botuar edhe editoriali i drejtorit të Agjencisë Kosovare Kundër-Korrupsionit. Editoriali shënonte ditën ndërkombëtare kundër-korrupsionit, dhe drejtori jep mesazhin edukativ për qytetarët e Kosovës se fenomeni korrupsion duhet të çrënjohet)
Dhjetor	<ul style="list-style-type: none"> - Gjatë këtij muaji ka pas mjaft shkrime për korrupsion, 15 shkrime që kanë dyshime për korrupsion . te gjitha shkrimet janë fokusuar si zakonisht në institucione publike PTK – KEK, nivelin komunal dhe atë qendror. (Në fund të këtij muaj është botuar në shumicën e medive të shkruara editoriali i drejtorit të AKK-së mbi rëndësinë që duhet të ketë lufta kundër korrupsionit gjatë vitit 2008)